

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 46, datë 13.4.2023

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS PËR ASGJËSIMIN E SENDEVE TË SEKUESTRUARA, AFATIT, SI DHE ORGANIT KOMPETENT PËR ASGJËSIMIN E TYRE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe nenit 215, pika 6, të ligjit nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Brendshëm,

UDHËZOJNË:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekt i këtij udhëzimi është:

- a) përcaktimi i organit kompetent për asgjësimin e sendeve të sekuestruara;
- b) përcaktimi i llojit të sendeve të sekuestruara të cilat do t’i nënshtrohen procedurës së asgjësimit;
- c) përcaktimi afatit për mbajtjen dhe asgjësimin e sendeve të sekuestruara.

II. ORGANI KOMPETENT PËR ASGJËSIMIN E SENDEVE TË SEKUESTRUARA

1. Në rastet kur gjykata urdhëron asgjësimin e sendeve të sekuestruara, prokurori, jo më vonë se 5 ditë nga marrja dijeni mbi urdhrin përkatës, ngre Komisionin e Asgjësimit të Sendeve (organi kompetent), për vijimin e procedurave të asgjësimit.

2. Komisioni përbëhet nga:

- a) oficeri i policisë gjyqësore,
- b) një përfaqësues nga Policia e Shtetit,
- c) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, dhe
- ç) një përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Kur është e mundur, anëtar i Komisionit është edhe një ekspert kriminalist i cili dokumenton procesin e asgjësimit me mjete audiovizive.

4. Anëtarët e përcaktuar në pikën 2 të këtij kreu, caktohen nga radhët e punonjësve të kualifikuar në fushën përkatëse për të cilën kërkohet asgjësimi.

5. Kur kërkohen njohuri të posaçme, për shkak të nevojave dhe kompleksitetit të çështjes, komisioni mund të asistohet edhe nga ekspertë të jashtëm.

III. PËRCAKTIMI I AFATIT PËR MBAJTJEN DHE ASGJËSIMIN E SENDEVE TË SEKUESTRUARA

1. Komisioni i Asgjësimit të Sendeve kryen procedurat e asgjësimit të sendeve të sekuestruara, menjëherë, por jo më vonë se 15 ditë nga njoftimi i urdhrit.

2. Në rast të pamundësisë së ekzekutimit të urdhrit të organit procedues, apo të respektimit të këtij afatit, Komisioni i dërgon organit procedues një relacion ku argumenton arsyet e moszekutimit të urdhrit, apo të mosrespektimit të afatit. Për vijimin e procedurave të mëtejshme, komisioni vepron sipas urdhërimeve përkatëse të organit procedues.

IV. PËRCAKTIMI I PROCEDURËS PËR ASGJËSIMIN E SENDEVE TË SEKUESTRUARA

1. Sende të sekuestruara në kuptim të këtij udhëzimi do të jenë ato sende të cilat mund të ndryshojnë ose sendet e ndaluara për t’u prodhuar, zotëruar, mbajtur apo tregtuar, në rast se ruajtja e tyre është e vështirë, veçanërisht e kushtueshme ose përbën rrezik për sigurinë, shëndetin apo higjienën publike.

2. Mënyra e asgjësimit të sendeve të sekuestruara, përcaktohet rast pas rasti nga komisioni, në varësi të llojit të sendeve për të cilat është vendosur asgjësimi, me kusht që procesi teknik i asgjësimit:

a) të kryhet në mënyrë që të garantohet siguria e jetës dhe shëndetit të pjesëmarrësve gjatë procesit, si dhe të popullatës;

b) të mos ketë pasoja të dëmshme mbi mjedisin.

3. Asgjësimi i sendeve të sekuestruara bëhet me dëgjie në inceneratorin e ndërtuar për këtë qëllim, por në varësi të llojit dhe sasisë, si dhe në mungesë të inceneratorit përcaktohet një vend i përshtatshëm për kryerjen e asgjësimit, i cili plotëson kriteret sipas legjislacionit në fushën e mjedisit.

4. Në çdo rast asgjësimi, përfaqësuesi i ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë udhëzon Komisionin mbi mënyrën e asgjësimit me qëllim shmangien e dëmtimeve në shëndetin e personave që marrin pjesë në procesin e asgjësimit.

5. Përfaqësuesi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, udhëzon komisionin mbi mënyrën dhe vendin e asgjësimit, me qëllim shmangien e dëmtimit në shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

6. Procedura e dokumentimit të veprimeve të kryera për asgjësimin e sendeve të sekuestruara, të bëhet sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Palët informojnë rregullisht njëra-tjetrën për problemet, që do të lindin gjatë zbatimit të këtij udhëzimi.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen organet e parashikuara në pikën 2, të kreut II të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi